

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5818
E enjte, 4 korrik 2019
çmimi 0.40 €

David-Maria Sassoli, president i ri i Parlamentit Evropian

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI | FAQE 4-5



Opozita s'ka pse të bëjë zhurmë, le ta bëjë mocionin nëse i ka numrat

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, aktualisht kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se Kuvendi nuk është duke e luajtur rolin kushtetues. Ai ka theksuar se zhvillimet e fundit tregojnë se ka rënë niveli i përfundimit, përgjegjësisë dhe debatit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka vlerësuar se debati i fundit në Kuvend për

Luginën e Preshevës u zhvillua për farsë patriotike e jo për zgjidhje politike. Ai ka deklaruar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka kthyer gjendjen e cila ka qenë para se të votohet delegacioni për bisedime. Kurse sa i përket paralajmërimit opozitar për mocionin ndaj qeverisë, Krasniqi ka thënë se opozita nuk ka pse bën zhurmë, por nëse i ka votat duhet ta rrëzojë qeverinë

- Kushtetuesja ktheu gjendjen aty ku ishte para se të votohej delegacioni për dialog

Haradinaj dhe Ahmeti vazhdojnë bashkëpunimin edhe për Prishtinën

FAQE 3

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë vazhduar bashkëpunimin për kryeqytetin. Ata të mërkurën kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, ndonëse kanë dallime të mëdha për jetëgjatësinë e qeverisë qendrore. Kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka thënë se opozita nuk i ka votat e nevojshme për ta rrëzuar qeverinë, ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se do ta respektojë çfarëdo vendimi të Kuvendit



Selimi: Presidenti dhe kryeministri po e bllokojnë funksionalizimin e ushtrisë

FAQE 7

OPINION

PSE ËSHTË E PAMUNDUR TË MPOSHTET NACIONALIZMI?

F. 11

Stephen M. WALT



AKTUALE



NIS RINOVIMI NË REPARTIN E EMERGENCËS NË SPITALIN E GJILANIT

F. 6

HARADINAJ KËRKON NGA FINLANDA NDIHMË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

F. 3

EKONOMI

BERZH-I DHE ODA AMERIKANE DISKUTOJNË PËR MUNDËSITË E MBËSHTETJES SË SEKTORIT PRIVAT

F. 9

LANSOHET 'E-TESTIMI' PËR PATENTSHOFERË

F. 9



KULTURË

GASHI: KOSOVA MERITON ANËTARËSIMIN NË TRADUK

F. 16

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Engel: Armiqësitë në Ballkanin Perëndimor duhet të tejkalohen

BEOGRAD, 3 KORRIK - Kongresisti amerikan Eliot Engel ka thënë, gjatë një bisede me deputetët serbë, se ShBA-ja dëshiron që dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës ta bëjë sa më të lehtë për të dyja palët.

Eliot Engel, që është edhe kryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Dhomës së Përfaqësuesve, po qëndron për vizitë në Serbi. Ai u takua të mërkurën me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nënkryetarin e Kuvendit të

Serbisë, Vladimir Marinković dhe një grup deputetësh serbë.

Engeli tha se të gjitha mosmarrëveshjet dhe armiqësitë në Ballkanin Perëndimor duhet të tejkalohen dhe se vendet e rajonit duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të bëhet anëtare të BE-së dhe të krijojnë një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët.

Deputetët serbë theksuan nevojën për vazhdimin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Ndërkaq, presidenti i

Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se shpreson që mesazhet e Eliot Engel në Prishtinë "do të kontribuojnë për krijimin e kushteve për vazhdimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës". Vuçiqi tha se me kongresistin amerikan gjithashtu kanë diskutuar për rastin e vëllezërve Bytyçi.

Agron, Yll dhe Mehmet Bytyçi kanë luftuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ligjvënësi amerikan Eliot Engel pritet ta vizitojë edhe Luginën e Preshevës. Më pas ai do të



qëndrojnë në Kosovë, ku do të ndërtesës së re të Ambasadës marrë pjesë në përrurimin e Amerikane në Prishtinë.

David-Maria Sassoli, president i ri i Parlamentit Evropian

Eurodeputeti italian David Maria Sassoli është zgjedhur të mërkurën president i Parlamentit Evropian. Ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula Von der Leyen, pritet ta zëvendësojë Jean-Claude Juncker, kurse kryeministri liberal belg Charles Michel pritet ta zëvendësojë presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk. Ndërkaq ministri i Jashtëm spanjoll, Josep Borrell, mund të jetë zëvendësuesi i Federica Mogherinit në postin e përfaqësuesit të lartë për politikën e jashtme të BE-së



PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Eurodeputeti italian David Maria Sassoli është zgjedhur të mërkurën president i Parlamentit Evropian, kjo pasi edhe liderët e BE-së rekomanduan që një socialist duhej të zgjidhej në krye të legjislaturës së re.

Sassoli mori 345 vota në raundin e dytë.

Në garë për këtë pozitë kanë qenë edhe Ska Keller (Greens/EFA, Gjermania), Sira Rego (GUE/NGL, Spanja) dhe Jan Zahradil (ECR, Çekia).

Ish-gazetari italian zëvendëson kështu Antonio Tajanin në rolin e ngjashëm, me atë të kryetarit të parlamentit.

Votimi në Parlamentin Evropian vjen një ditë pasi liderët e BE-së ranë dakord për nominimet, për postet kryesore të bllokut me një grua, që për të parën herë

propozohet si shefe e Komisionit Evropian.

Ambasadorja e Republikës së Kosovës në Itali, Alma Lama, ka uruar në këtë pozitë të re David-Maria Sassoli. "Shumë urime presidentit të sapozgjedhur të Parlamentit Evropian, David Sassoli, me të cilin kam pasur rastin të njihem dhe të bashkëpunoj gjatë punës sime si ambasadore e Republikës së Kosovës në Itali. Ai është një përkrahës i madh i Kosovës që prej kohës së luftës kur ka punuar si drejtor i lajmeve në RaiUno. Ai do na përkrahë në agjendën evropiane, është mbështetës i Kosovës", ka shkruar Lama në llogarinë e vet në "Facebook".

Zgjedhja surprizë e ministres gjermane të Mbrojtjes, Ursula Von der Leyen, për të zëvendësuar Jean-Claude Juncker, pasoi

negociata të vështira që çuan në refuzimin e pretendentëve kryesorë.

Emri i saj duhet të miratohet nga një shumicë eurodeputetësh, në një votim që do të mbahet në Strasburg më 15 korrik. Nëse kandidatura e saj refuzohet, liderët kombëtarë do të kenë edhe një muaj kohë për të nominuar një zëvendësues.

Kristine Lagarde, shefja aktuale e Fondit Monetar Ndërkombëtar, është nominuar si gruaja e parë në krye të Bankës Qendrore Evropiane.

Ndërsa kryeministri liberal belg

Charles Michel është zgjedhur për ta zëvendësuar presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk. Ministri i Jashtëm spanjoll, Josep Borrell, mund të jetë zëvendësuesi i Federica Mogherinit në postin e përfaqësuesit të lartë për politikën e jashtme të BE-së. Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se Kosova mirëpret udhëheqjen e re të Bashkimit Evropian. "Kosova mirëpret udhëheqjen e re të Bashkimit Evropian. Ne besojmë se nuk varet nga origjina kombëtare roli që dikush do të luajë

në Bashkimin Evropian dhe politika e jashtme e Bashkimit Evropian varet nga shtetet anëtare nga të cilat shumica e kanë njohur Kosovën", ka thënë Pacolli. Ai ka thënë se Kosova pret që Bashkimi Evropian të marrë një vendim për liberalizimin e vizave. "Çdo vonesë e mëtejshme nuk ka arsye. Sikurse kanë konfirmuar Komisioni Evropian dhe Parlamenti, Kosova ka përmbytur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe nuk duhet të ketë arsye politike që pengojnë këtë proces teknik", është shprehur Pacolli.

KE: Nuk pezullohen vizat për Shqipërinë

TIRANË, 3 KORRIK - Pas kërkesës së marrë nga Holanda, Komisioni Evropian sqaron se në situatën aktuale rrethanat për ta vënë në lëvizje mekanizmin e pezullimit të vizave me Shqipërinë nuk plotësohen.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian për Migracionin,

Çështjet e Brendshme dhe Shtetësinë, Tove Ernst, konfirmoi të mërkurën për ATSh-në se "pas një vlerësimi të kujdesshëm të përmbajtjes së njoftimit të marrë nga Holanda dhe bazuar në informacionin në dispozicion dhe të dhënat përkatëse, Komisioni arriti në përfundimin

se në situatën aktuale rrethanat për ta vënë në lëvizje mekanizmin e pezullimit të vizave nuk plotësohen".

Ernst deklaroi se "komisioni do të vazhdojë të monitorojë nga afër përmbushjen e standardeve të liberalizimit të vizave për Shqipërinë si dhe për vendet e

tjera që përfitojnë nga udhëtimi pa viza".

Më 31 maj Holanda dorëzoi zyrtarisht në Komisionin Evropian kërkesën e saj për pezullimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve shqiptarë në zonën Shengen, kërkesë e cila u rrëzua të mërkurën nga KE-ja.



Qeveria ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës

Haradinaj dhe Ahmeti vazhdojnë bashkëpunimin edhe për Prishtinën

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë vazhduar bashkëpunimin për kryeqytetin. Ata të mërkurën kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, ndonëse kanë dallime të mëdha për jetëgjatësinë e qeverisë qendrore. Kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka thënë se opozita nuk i ka votat e nevojshme për ta rrëzuar qeverinë, ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se do ta respektojë çfarëdo vendimi të Kuvendit

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Kryeministrin Ramush Haradinaj dhe kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmetin, nuk i kanë penguar dallimet rreth qeverisjes në vend për ta zgjeruar bashkëpunimin mes tyre. Ata të mërkurën kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës, ani pse i pari i kryeqytetit kërkon rrëzimin e qeverisë Haradinaj.

Kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, e ka pranuar se opozita ende nuk i ka votat e nevojshme për rrëzimin e qeverisë. "Kjo punë është edhe me Kushtetutë. Këtë e dimë edhe unë dhe z. Haradinaj. Po t'i kishim votat mendoj se sot e kishim thirrur seancën", ka thënë Ahmeti. Ai ka deklaruar se me Listën Serbe nuk do ta rrëzojnë qeverinë. "E kam thënë edhe më herët, dhe besoj se ky është qëndrim edhe i LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje, se me Listën Serbe nuk jemi të interesuar për ta rrëzuar qeverinë. Në kohën kur e kemi taksën dhe diskutimet me Serbinë për marrëveshjen përfundimtare, besoj se nuk është mirë të bashkëpunojmë me dikë që vendos në Beograd", ka thënë Ahmeti.

I pari i PSD-së ka treguar se për të diskutuar rreth mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë në ditët në vijim do ta ftojë në një takim

liderin e LDK-së, Isa Mustafa, dhe atë të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. "Në ditët në vijim do t'ju dërgoj një ftesë, edhe pse ndoshta nuk na takon neve PSD-së, por meqenëse momentalisht kemi vetëm fjalë për iniciativa të tilla, kam kërkuar për të parë se cili është bashkëveprimi opozitar ndaj qeverisë", ka thënë ai.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se nuk frikësohet nga mocioni i opozitës. "Kushdo që është në pushtet frikësohet mos po e rrëzojnë. Kur kam qenë në opozitë kam qenë pak më rehat. Prej që jam në punë, kam shumë punë dhe shumë ngarkesa. Unë nuk do të ndalem në punë. Detyra ime është se për aq sa jam në punë të avancojnë proceset. Edhe sikur të ishte dita e fundit e qeverisë unë shkoj në shtëpi dhe mburrem me atë çfarë kam bërë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se do ta respektojë çdo vendim të Kuvendit. "Është e logjikshme se nëse i bëjnë 61 vota, e pranoj vendimin e Kuvendit dhe shkojmë në zgjedhje", është shprehur Haradinaj.

Kërkohet unitet për dialog

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari Shpend Ahmeti, pavarësisht se kanë pranuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për delegacionin shtetëror për bisedime me

Serbinë, kanë deklaruar se pozita dhe opozita duhet të bashkëpunojnë për këtë proces. Haradinaj ka thënë se dialogu me Serbinë nuk është përgjegjësi vetëm e qeverisë. "E admiroj PSD-në për guximin për të marrë përgjegjësi në këto rrethana. Ne kemi qenë të kritikuar dikur prej opozitës kur kemi marrë pjesë në dialog dhe për këtë e kemi paguar çmimin. Mirëpo ndonjëherë është më mirë të jesh pjesë e tavolinës. Unë çdoherë kam thënë se para se ta kritikojmë procesin të afrohem në tavolinë", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova në këtë proces duhet të jetë e bashkuar. "Kam qenë i interesuar që në etapën finale të dialogut të jemi të gjithë bashkë, sepse është momenti final. Prapë mendoj se të gjitha partitë politike, në këtë rast edhe PSD-ja, shpresoj se do ta gjejë fuqinë që ta ndihmojë vendin e vet", është shprehur Haradinaj.

Edhe kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka thënë se për këtë proces do të vazhdojë të bashkëpunojë me partitë e tjera.

Nis realizimi i projektit për Prishtinën e Re

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës i pari i kryeqytetit ka thënë se pas disa muajsh diskutimesh dhe negociatash kanë arritur të merren vesh që projekti i zgjerimit të Prishtinës në Prishtinën e Re të bëhet në bashkëpunim të plotë në mes të Komunës së Prishtinës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Vizioni ynë është që t'i japim drejtim se kah do të zhvillohet Prishtina dhe, po ashtu, të planifikojmë të ndërtojmë si dhe ta heqim presionin nga kryeqyteti", ka thënë ai, duke shtuar se zhvillimi i Prishtinës do të shkojë kah Prishtina e Re dhe u zotua se

çdo gjë do të bëhet bashkë dhe në mënyrë transparente. Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kjo është ngjarje e rëndësishme për kryeqytetin. "Qeveria e vendit më 13 prill 2018 e ka shpallur Zonë me rëndësi të veçantë hapësirën për ndërtimin e Kompleksit Qeveritar dhe më 25 qershor është aprovuar. Pra, jam autorizuar për nënshkrimin e Memorandumit me kryetarin dhe sot po e nënshkruajmë këtë memorandum. Kjo nënkupton se jemi palë në zbatimin e këtij projekti, projekt ky më i madhi infrastrukturor në tërësi dhe zhvillimor me interes për institucionet e vendit, për qytetarët, për kryeqytetin", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Haradinaj kërkon nga Finlanda ndihmë për liberalizimin e vizave



PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorën e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, me të cilën ka biseduar për aktualitetin politik, çështjen e liberalizimit të vizave, bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve si dhe e ka uruar për marrjen e kryesimit të Këshillit të BE-së nga Finlanda. Në këtë takim kryeministri Haradinaj e ka njoftuar ambasadorën për prioritetet e Qeverisë së Kosovës në zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, fuqiz-


imin e sundimit të rendit dhe ligjit dhe orientimin euroatlantik të shtetit të Kosovës. Kryeministri Haradinaj e ka falënderuar ambasadorën Stjernvall dhe shtetin e Finlandës për përkrahjen e Kosovës deri më tani në të gjitha fazat e shtetndërtimit, në të njëjtën kohë ka kërkuar që Finlanda gjatë kryesimit të Këshillit të BE-së të luajë rol mbështetës edhe në përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave si një e drejtë e merituar për popullin e Kosovës. "Me marrjen e kryesimit të Këshillit të BE-së, Finlanda

mund të luajë rol të rëndësishëm në avancimin e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar se institucionet e Kosovës kanë përbushur të gjitha kriteret e vëna nga Bashkimi Evropian, andaj lëvizja e lirë për qytetarët e Kosovës është domosdoshmëri. Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall, vlerësoi përparimin e Kosovës, duke thënë se Finlanda do ta vazhdojë bashkëpunimin me Kosovën në të gjithë fushat e interesit të përbashkët.

Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

Opozita s'ka pse të bëjë zhurmë, le

- Kushtetuesja ktheu gjendjen aty ku ishte para se të votohej delegacioni për dialog



Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, aktualisht kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se Kuvendi nuk është duke e luajtur rolin kushtetues. Ai ka theksuar se zhvillimet e fundit tregojnë se ka rënë niveli i përfaqësimit, përgjegjësisë dhe debatit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka vlerësuar se debati i fundit në Kuvend për Luginën e Preshevës u zhvillua për farsë patriotike e jo për zgjidhje politike. Ai ka deklaruar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka kthyer gjendjen e cila ka qenë para se të votohet delegacioni për bisedime. Kurse sa i përket paralajmërimit opozitar për mocionin ndaj qeverisë, Krasniqi ka thënë se opozita nuk ka pse bën zhurmë, por nëse i ka votat duhet ta rrëzojë qeverinë

parë që sa kohë është treguesi më i mirë se spiralja e përfaqësimit ka rënë shumë dhe bashkë me të ka rënë edhe niveli i përgjegjësisë dhe i debatit, madje jo vetëm në Kuvend, por edhe përgjithësisht në shoqërinë shqiptare", është shprehur Krasniqi, duke shtuar se debati i fundit në Kuvend për Luginën e Preshevës u zhvillua për farsë patriotike e jo për zgjidhje politike. "Kështu si është duke u zhvilluar debati në Kuvendin e Kosovës, nuk është debat për asnjë zgjidhje, se jo më për çështjen e Kosovës Lindore. Sa i përket dialogut, kjo çështje është dashur të jetë pjesë e tij që nga fillimi. Mungesa e kuorumit flet se te ne ka shumë farsë. Këtu debati është duke u zhvilluar për farsë patriotike, jo për zgjidhje politike", ka theksuar ai. Ish-kryetari i Kuvendit të

Kosovës ka thënë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka kthyer gjendjen e cila ka qenë para se të votohet delegacioni për bisedime. Madje, sipas Krasniqit, për këtë çështje as që është dashur t'i drejtohej gjykatës. "Gjykata Kushtetuese gjendjen e ka kthyer aty ku ishte para se të votohej delegacioni për bisedime. Prandaj për këtë çështje as që është dashur t'i drejtohej asaj. Por, 'kur nuk ke çka të bësh, luaje derën', thotë një fjalë", ka deklaruar ai. Krasniqi e ka komentuar edhe paralajmërimin e opozitës për iniciimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, me ç'rast ka thënë se opozita nuk duhet të bëjë zhurmë, por nëse i ka votat, duhet ta rrëzojë. "Opozita nuk ka pse bën zhurmë për këtë çështje. Ajo duhet ta bëjë mocionin nëse i ka numrat", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se nuk është i

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ish-kryeparlamentari i Kosovës, aktualisht kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë të mërkurën

se në vendin tonë asnjë institucion e as Kuvendi nuk është duke e luajtur rolin e tij kushtetues. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se zhvillimet e fundit janë treguesi më i mirë se ka rënë spiralja e përfaqësimit dhe niveli i

përgjegjësisë dhe i debatit. "Jo vetëm Kuvendi, por me këtë kulturë politike që është formësuar në Kosovë në përgjithësi e me kulturën e përfaqësimit në veçanti, asnjë institucion, as Kuvendi, nuk mund ta luajë rolin e vet kushtetues. Kjo që e kemi

ta bëjë mocionin nëse i ka numrat

edhe niveli i përgjegjesisë dhe i debatit, madje jo vetëm në Kuvend, por edhe përgjithësisht në shoqërinë shqiptare.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, si e vlerësoni punën e Kuvendit gjatë kësaj legjislature dhe a po arrin ta luajë rolin që i takon ky institucion?

Krasniqi: Jo vetëm Kuvendi, por me këtë kulturë politike që është formësuar në Kosovë në përgjithësi e me kulturën e përfaqësimit në veçanti, asnjë institucion, as Kuvendi, nuk mund ta luajë rolin e vet kushtetues.

"Epoka e re": Gjatë kësaj periudhe shumë seanca janë ndërprerë në mungesë të kuorumit. Rasti i fundit ishte mosmiratimi i rezolutës për Luginën e Preshevës. Prisni një dinamikë më të madhe të legjislativit në sesionin vjeshtor?

Krasniqi: Kjo që e kemi parë që sa kohë është treguesi më i mirë se spiralja e përfaqësimit ka rënë shumë dhe bashkë me të edhe niveli i përgjegjesisë dhe i debatit, madje jo vetëm në Kuvend, por përgjithësisht në shoqërinë shqiptare.

"Epoka e re": Si e keni parë debatin për Luginën dhe cila mendoni se është rruga e duhur që Kosova, por edhe Shqipëria, t'i ndihmojë këto tri komuna shqiptare. Është kërkuar që kjo çështje të jetë pjesë e dialogut Kosovë - Serbi dhe një përfaqësues i saj të jetë pjesë e delegacionit të bisedimeve mund të ndodhë kjo apo do të mbetet vetëm çështje deklarative?

Krasniqi: Kështu si është duke u zhvilluar debati në Kuvendin e Kosovës, nuk është debat për asnjë zgjidhje se jo më për çështjen e Kosovës Lindore. Sa i përket dialogut, kjo çështje është dashur të jetë pjesë e tij që nga fillimi. Mungesa e kuorumit flet se te ne ka shumë farsë. Këtu debati është duke u zhvilluar për farsë patriotike, jo për zgjidhje politike.

"Epoka e re": Pas zhvillimeve të fundit, përkatësisht pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese e cila e ka shpallur jokushtetues Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, si e shihni vazhdimin e dialogut?

Krasniqi: Gjykata Kushtetuese gjendjen e ka kthyer aty ku ishte para se të votohej delegacioni për bisedime. Prandaj për këtë çështje as që është dashur t'i drejtohej asaj. Por, 'kur nuk ke çka të bësh, luaje derën', thotë një fjalë.

"Epoka e re": Opozita të martën ka paralajmëruar se së shpejti do të ngrehë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Haradinaj. Mendoni se opozita mund t'i sigurojë edhe tri vota për t'u arritur synimi i saj, rrëzimi i qeverisë?

Krasniqi: Opozita nuk ka pse bën zhurmë për këtë çështje. Ajo

duhet ta bëjë mocionin nëse i ka numrat.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, sa jeni i kënaqur me bashkëqeverisjen e deritashme dhe cili është bashkëpunimi aktual mes partnerëve të koalicionit qeverisës?

Krasniqi: Nëse qytetarët e Kosovës

nuk janë të kënaqur me mënyrën se si qeveriset vendi, atëherë asnjë njeri politik nuk ka mundësi të jetë i kënaqur kur i sheh të rinjtë e të rejtat e këtij vendi të largohen nga atdheu. Nga mënyra se si komunikohet në publik, nuk duket se komunikimi është i duhuri, pra lë për të dëshiruar shumë.

Projekti 'Kosovë e shëndetshme' u ndan grante organizatave të shoqërisë civile

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Projekti 'Kosovë e shëndetshme' ka nënshkruar të mërkurën marrëveshje me gjashtë organizata të shoqërisë civile që do të ofrojnë grante me vlerë të ulët për ta ndihmuar financimin e zbatimit të politikave dhe standardeve aktuale në lidhje me strategjitë e zvogëlimit të ndotjes së mjedisit. Kjo përfshinë funksionet e vëzhgimit mbi proceset vendimmarrëse, avokimin dhe lobimin për t'i përmirësuar të drejtat e qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër.

Në fjalën e saj përshëndetëse Ulrika Richardson, koordinatore e OKB-së për Zhvillim, ka falënderuar të gjitha organizatat e shoqërisë civile për propozimet dhe punën e tyre që do të ndikojë në cilësinë e jetës së njerëzve në Kosovë. "Të gjithë varem nga mjedisi dhe degradimi i mjedisit ndikon te të gjithë ne! Prandaj, të gjithë së bashku duhet të ndërmarrim veprime për t'i ndaluar prirjet negative të ndryshimeve klimatike, grumbullimit të pakontrolluar të mbeturinave

dhe ndotjes së ajrit. Organizatat e shoqërisë civile dhe mediet kanë rol veçanërisht të rëndësishëm si 'watchdog' - mbikëqyrës për ta rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e rinisë dhe komuniteteve për veprim individual dhe kolektiv. Ekipi i OKB-së në Kosovë me projektin 'Kosovë më e shëndetshme' të UNDP-së, OBSH-së dhe vullnetarëve të OKB-së në partneritet me Qeverinë e Luksemburgut do të vazhdojnë të punojnë me shoqërinë civile në të gjitha komunitetet", ka thënë Richardson.

Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, ka theksuar se ndotja e ajrit është një nga problemet më të mëdha që ndikojnë në jetën e njerëzve në Kosovë, duke rrezikuar seriozisht shëndetin e njerëzve, veçanërisht të fëmijëve dhe të moshuarve. "UNDP i jep prioritet të lartë kësaj iniciative të përbashkët dhe ne jemi të kënaqur që kemi marrë shumë propozime nga OBSH-të, të cilat me të vërtetë kujdesen për mjedisin dhe përpiqen t'i ndryshojnë gjërat. Kjo inicia-

tivë e përbashkët na lejon të bëjmë partneritet me aktorë të ndryshëm për trajtimin e ndotjes së ajrit dhe rreziqeve që kjo ndotje paraqet për shëndetin e njerëzve. Ne duhet të punojmë me ekspertë, zyrtarë qeveritarë, politikanë, vendimmarrës vendorë, biznese dhe me komunitetet e prekura. Ne besojmë se OBSH-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm për trajtimin e problemeve mjedisore në Kosovë. Unë pres që t'i shoh rezultatet e arritura nga këto grante dhe besoj se ato do të kontribuojnë që Kosova të bëhet një vend më i mirë për të gjithë, përfshirë edhe gjeneratat e ardhshme", ka thënë Suokko.

Fehmije Mydyti nga Ambasada e Luksemburgut ka theksuar se është një arritje pozitive që Qeveria e Luksemburgut të mbështesë një iniciativë ose një partneritet në një fushë jetike siç është mjedisi dhe shëndeti në Kosovë. "Ne mezi presim që të shohim rezultatet e shoqërisë civile dhe përpjekjet e saj për ta zbutur problemin e ndotjes së mjedisit", ka thënë Mydyti.



kënaqur me zhvillimet politike dhe largimin e të rinjve nga Kosova. "Nëse qytetarët e Kosovës nuk janë të kënaqur me mënyrën se si qeveriset vendi, atëherë asnjë njeri politik nuk ka mundësi që të jetë i kënaqur kur i sheh të rinjtë e të rejtat e këtij vendi të largohen nga atdheu. Nga mënyra se si komunikohet në publik edhe nuk duket se komunikimi është i duhuri, pra lë për të dëshiruar shumë", është shprehur Krasniqi.

"Epoka e re": Gjatë kësaj periudhe shumë seanca janë ndërprerë në mungesë të kuorumit. Rasti i fundit ishte mosmiratimi i rezolutës për Luginën e Preshevës. Prisni një dinamikë më të madhe të legjislativit në sesionin vjeshtor?

Krasniqi: Kjo që e kemi parë që sa kohë është treguesi më i mirë se spiralja e përfaqësimit ka rënë shumë dhe bashkë me të ka rënë

Nis rinovimi në Repartin e Emergjencës në Spitalin e Gjilanit

"Spitali i Gjilanit ka pasur nevojë për investime. Kërkesës së pacientëve dhe profesionistëve shëndetësorë të këtij qyteti iu kemi përgjigjur me projekte konkrete për ndryshimin e gjendjes", ka thënë ministri Uran Ismaili pas vizitës që i ka bërë Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të mërkurën Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, në të cilin kanë nisur një sërë investimesh për përmirësimin e infrastrukturës së reparteve të këtij institucioni.

Ministri Ismaili gjatë kësaj vizite ka treguar se tashmë ka nisur puna për rinovimin e tërësishëm të Emergjencës. "Spitali i Gjilanit ka pasur nevojë për investime. Kërkesës së pacientëve dhe profesionistëve shëndetësorë të këtij qyteti iu kemi përgjigjur me projekte konkrete për ndryshimin e gjendjes. Rinovimi i tërësishëm i repartit të emergjencës me infrastrukturë të re, pajisje moderne dhe inventarë të përshatshëm mjekësor, do ta rrisë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore. Pas emergjencës do të nisë menjëherë rinovimi i ambulancave specialiste në të mirë pacientëve të këtij spitali", ka thënë ai. Ismaili ka thënë se duke investuar në institucionet publike shëndetësore synohet që të rriten cilësia dhe siguria e shërbimeve shëndetësore për qyte-

tarët.

Rinovimi i repartit të emergjencës në spitalin e përgjithshëm të Gjilanit përfshinë blerjen e aparaturave moderne, ndërrimin e dymëve dhe dritareve, dyshemesë, njeve sanitare dhe punë të tjera. Po ashtu, do të blihet edhe inventari i ri mjekësor për të gjithë repartin, me shtretër për pacientë, karroca, dollapë për barna etj.

Drejtori i Spitalit të Gjilanit, Nisret Hajrullahu, ka thënë se ky investim është shumë i mirëpritur. "Ka kohë që në Spitalin e Gjilanit nuk ka pasur investime për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe ministrin Ismaili për angazhimin që qytetarëve të Gjilanit t'u ofrojnë kushte më të mira për shërbimet mjekësore", ka thënë Hajrullahu.

Emergjencja e këtij spitali nuk do të jetë investimi i vetëm që do të bëhet gjatë këtij viti. Brenda pak ditësh do të nisë puna edhe për rinovimin e tërësishëm të ambulancave specialiste për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në të mirë të pacientëve të këtij spitali.



Kosova dhe Katari thellojnë bashkëpunimin në fushën e emergjencave dhe trajnimit të kuadrove

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra, së bashku me delegacionin me përfaqësues nga Ministria e Brendshme e shtetit të Katarit i cili po qëndron në Kosovë, kanë vizituar Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Në vizitën e realizuar në AME, delegacioni nga shteti i Katarit u prit nga kryeshefi i kësaj agjencie, Fadil Kodra, me bashkëpunëtorët e tij, që prezantuan para të pranishmëve punën dhe aktivitetet e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent. Me këtë rast, përfaqësuesi i delegacionit, Kolonel Ali Hassan Al-Kubaisi, drejtor i Departamentit të Krimeve Ekonomike dhe Elektronike, shprehi gatishmërinë e shtetit të

Katarit për të ofruar ndihmë në pajisje dhe trajnime për avancimin e mëtejshëm të AME-së.

Për ta parë më afër ambientin dhe kushtet e punës, vizita e delegacionit nga Katarit vazhdoi te Brigada e Zjarrfikësve në Prishtinë.

Më pas, zëvendësministri Shkodra, së bashku me delegacionin mysafir, vizituan Akademinë e Kosovës për Siguri Publike ku u takuan me drejtorin e Përgjithshëm të Akademisë, Ismail Smakiqi.

Gjatë takimit mes të dy palëve u bisedua rreth gjetjes së mënyrës së bashkëpunimit në fushën e ngritjes së kapaciteteve për institucionet ligjzbatuese në mes të AKSP-së dhe Akademisë së Sigurisë Publike të Katarit.

Delegacioni nga Katarit shfaqti interesim rreth procesit të



rekrutimit të zyrtarëve të sigurisë publike në Kosovë si dhe

rreth zhvillimit të trajnimeve në AKSP. Në fund delegacioni bëri

një vizitë nëpër ambientin e Akademisë.

Ish-eprori i UÇK-së, Remzi Shala, dënohet me 14 vjet burgim

PRISHTINË, 3 KORRIK - Gjykata Themelore e Prizrenit, Departamenti i Krimeve të Rënda, e ka dënuar me 14 vjet burgim të akuzuarin me iniciale R. Sh., me pseudonim "Molla e

Kuqe", nga fshati Shirokë, Komuna e Suharekës, për veprën penale "krime lufte kundër popullsisë civile". "Gjykata e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me burgim në

kohëzgjatje prej 14 vjetësh, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 24. 05. 2019 e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi", thuhet në

njoftimin e publikuar nga Gjykata.

Mediat lokale bëjnë me dije se bëhet fjalë për Remzi Shalën, ish-eprorin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Rexhep Selimi, ka mbajtur konferencë për medie

Selimi: Presidenti dhe kryeministri po e bllokojnë funksionalizimin e ushtrisë

Zëvendëskryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Rexhep Selimi, ka thënë se presidenti, kryeministri dhe ministri i Mbrojtjes po e bllokojnë funksionalizimin e ushtrisë së Kosovës. Në një konferencë me gazetarë të mërkurën, ai ka thënë se një pjesë e madhe e personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes si dhe personeli i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenden në një situatë konfuziteti si pasojë e mosfunksionalizimit të strukturave të reja të planifikuara sipas ligjeve në fuqi



EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh zëvendëskryetar i komisionit parlamentar për sigurinë dhe FSK-në, Rexhep Selimi, të mërkurën ka akuzuar presidentin, kryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes se po e bllokojnë funksionalizimin e ushtrisë së Kosovës. Në një konferencë me gazetarë ai ka thënë se aktualisht një pjesë e madhe e personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe personeli i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenden në një situatë konfuziteti si pasojë e mosfunksionalizimit të strukturave të reja të planifikuara sipas ligjeve në fuqi. "E gjithë kjo situatë derivon nga mosdekretimi i gjeneralëve të rinj nga ana e presidentit të Kosovës që ka sjellë bllokimin edhe të emërimeve të tjera në pozitat e reja konform strukturës së re të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke krijuar një efekt zinxhir pothuajse në të gjitha nivelet. Presidenti nuk po do t'i dekretojë

liderët kyçë dhe motivet janë thjesht dhe vetëm personale, pra të ndikimit të tij të drejtpërdrejtë. Kryeministri është vetëmjaftuar me mburrje se në mandatin e tij janë votuar ligjet për FSK-në, kurse ministri dhe Ministria e Mbrojtjes gjenden në një kaos dhe aktiviteti i tyre kryesor është mbushja e ministrisë me militantë partiake të partive në pushtet. Viojnë vendimet sa të paligjshme aq dhe kontroverse prej shkarkimeve dhe emërimeve të sekretarit të përgjithshëm të mungesa e kontratës për pajisje me uniforma dhe veshmbathje për rekrutët e rinj dhe të mungesa e rregullores së pagave", ka deklaruar Selimi.

Ndërsa te pozicionimi i shërbyesve civilë ai ka thënë se është duke ndodhur një luftë mes partive të koalicionit qeverisës se cila do të punësojë më shumë si dhe t'i sistemojnë militantët e tyre në pozita drejtuese. "Një pjesë e personelit civil në Ministrinë e Mbrojtjes vazhdon t'i kryejë detyrat ditore bazuar në kompetencat e pozitës konform strukturës së vjetër, ndërkohë që zyrtarisht janë të sistemuar në

pozita konform strukturës së re të Ministrisë së Mbrojtjes (strukturë e cila nuk është funksionale), ndërsa sistemimi i pjesës së udhëheqësve (liderët kyçë: drejtorët e drejtorive, drejtorët e departamenteve dhe shefat e sektorëve) nuk është bërë ende. Si rrjedhojë e kësaj, në Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për formimin Shtabit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe strukturave në varësi", ka deklaruar Selimi.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës ka thënë se procesi i transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës përmes miratimit të pakos ligjore nuk ka filluar ende së realizuar falë bllokadës absurde dhe të dëmshme të presidentit, kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes. "Parlamenti i Republikës së Kosovës më 14 dhjetor 2018, me përkrahje të të gjitha grupeve të partive politike parlamentare, miratoi tri ligje: Ligji për

Ministrinë e Mbrojtjes, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Sipas afateve kohore të paraqitur në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, më 21 maj 2019 ka qenë dashur të përfundojë pjesa e parë e fazës së parë 'A+120 ditë'. Bazuar në këtë plan, 'Dita A' është dita e hyrjes në fuqi të pakos ligjore, pra 21 janar 2019. Sot jemi më 3 korrik, 6 muaj e gjysmë nga dita e votimit në Kuvend të ligjeve për ushtrinë e Kosovës, afër 5 muaj e gjysmë nga hyrja në fuqi e ligjeve dhe rreth 1 muaj e gjysmë pas kalimit të afatit të përcaktuar nga plani gjithëpërfshirës", ka theksuar ai, duke shtuar se gjatë kësaj periudhe është dashur të bëhet riorganizimi i Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe Komandës së Forcave Tokësore në Shtabin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Po sipas Selimit, gjatë kësaj periudhe ministria dhe komanda është dashur të kalojnë

në tabelën organizative të re dhe personeli të jetë vendosur në pozitat e reja. Ai ka thënë se nuk është realizuar as vendosja e elementit drejtues (udhëheqës) si shefi i stafit të Shtabit të FSK-së, sekretari i përgjithshëm dhe liderët kyçë, gjeneralët dhe drejtorët e drejtorive në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK. "Projektet kryesore gjatë kësaj faze të cilat tashmë është dashur të jenë të përfunduara (fatkeqësisht asnjë nuk është e gatshme apo i miratuar nga autoritetet e Ministrisë dhe FSK) janë: krijimi i dokumenteve strategjike si strategjia e mbrojtjes, ajo për anëtarësim dhe integrim në strukturat rajonale si dhe vendosja e bazës doktrinale për riorganizimin e komandave, pra tabelat organizative të personelit dhe pajisjeve si dhe misionet, konceptet operacionale, procedurat taktikat dhe teknikat, manualët. As ky objektivi nuk është arritur", është shprehur Selimi.

Tahiri: Kosova, anëtare e besueshme e BE-së në luftën kundër terrorizmit

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të mërkurën në takim delegacionin e ekspertëve të Bashkimit Evropian që po qëndron në vizitë në Kosovë për të diskutuar për veprimet e Kosovës në zbatimin e planit të përbashkët kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Ministri Tahiri ka njoftuar delegacionin për ndryshimet ligjore, nisur nga ndryshimi i Kodit të ri Penal si dhe Kodit të ri të Procedurës Penale, që tashmë parasheh edhe gjykimin në mungesë dhe zgjatjen e hetimit për veprat e tilla dhe që do të ndihmojnë Kosovën në luftim më efikas të këtyre dukurive. Këto ndryshime ligjore, sipas ministrit Tahiri, kanë mundësuar

edhe krijimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit, që do t'i trajtojnë lëndët e Prokurorisë Speciale, duke dëshmuar përkushtimin dhe vendosmërinë e institucioneve për luftë të pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Në kuadër të planit të përbashkët ministri Tahiri ka përmendur aksionin e përmbyllur më 19 prill, që ktheu në Kosovë 110 qytetarët kosovarë nga Siria. Ministri Tahiri ka siguruar delegacionin e Bashkimit Evropian që të gjithë të dyshuarit do të dalin para drejtësisë, ndërsa viktimat do ta vazhdojnë rehabilitimin e tyre dhe riintegrimin në shoqëri. Duke qenë anëtarë të Aleancës



Globale Kundër ISIS, institucionet e Kosovës do të vazhdojnë të jenë të vendosura për përmbylljen e obligimeve të saj, ka thënë

ministri Tahiri, duke theksuar se do të punohet që emri i Republikës së Kosovës të mos ndërlidhet në asnjë formë me

luftën që po zhvillohet në Siri. Gjithashtu, ministri u zotua për zbatim efektiv të planit të përbashkët kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha shtetet e rajonit dhe shtetet anëtare të BE-së dhe ta ofrojë përvojën e Republikës së Kosovës nga procesi i kthimit, programeve të rehabilitimit dhe riintegrimit. Nga ana e tyre, delegacioni nga Bashkimi Evropian ka përgëzuar ministrin Tahiri për guximin e treguar në aksionin për kthimin e qytetarëve nga zona e konfliktit, rezultatet e arritura në përgjithësi në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe bashkëpunimin me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të saj.

Ministrja Ziviq viziton Institutin e Pylltarisë në Pejë

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministrja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Dijana Ziviq, e shoqëruar nga kryeshefi i Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, Ahmet Zejnullahu, ka vizituar të mërkurën Institutin e

Pylltarisë së Kosovës në Pejë. Me këtë rast, ata kanë vizituar hapësirat e këtij instituti, duke parë nga afër punën që bëhet aty. "Instituti Pyjor ka një rëndësi të madhe dhe është një shembull i vërtetë i

bashkëpunimit të mirë midis sektorit të biznesit, shkencës dhe ekonomisë, i cili në mënyrën më të mirë kombinon prodhimin, shkencën, teknologjinë dhe shërbimet për zhvillimin e bujqësisë dhe pyll-

tarisë në Kosovë", ka deklaruar Ziviq. Ajo ka shtuar se në kuadër të këtij instituti funksionon sektori për dizajnimin dhe hulumtimin si dhe sektori i pyllëzimeve dhe prodhimeve të fidanëve. Ministrja Ziviq me drejtuesit e

institutit nga afër ka vizituar edhe laboratorin e këtij instituti i cili merret me mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit dhe insektet si dhe pemishten e institutit, i cili ka më shumë se 10 hektarë dhe 1 milion e 400 mijë fidanë.



Lekaj u mundëson banorëve kycjen në Llozicë



PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën ka përfunduar fillimin e punimeve për realizimin e hyrje-daljes së Llozicës, kycje e cila garanton sigurinë e komu-

nikacionit përgjatë rrugës Nacionale N9, Prishtinë - Pejë dhe banorëve të kësaj ane. Kycja e kësaj pjesë është kërkesë e kamotshme e banorëve të kësaj ane, të cilën ministri Lekaj ua realizoi.

Ministri Lekaj ka kërkuar nga punëkryesi që punimet të realizohen sipas planit dinamik të paraparë, në mënyrë që sa më parë të përfundojë kjo hyrje-dalje me rëndësi për sigurinë e komunikacionit dhe banorëve

të këtij lokaliteti. Hyrje-dalja e Llozicës që do të realizohet në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve ka vlerë afër 100 mijë euro dhe do të përfundojë brenda dhjetë ditësh. Projekti do të realizohet me

standardet më të larta të sigurisë rrugore, do të garantojë lëvizje të sigurt në këtë segment rrugor dhe hyrje-dalje për banorët e Llozicës dhe fshatrave të tjerë që lidhen me rrugën Nacionale N9.


Lansohet "e-Testimi" për patentshoferë

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën mori pjesë në lansimin e testimit elektronik "e-Testimi" për provimin e patentshoferit. Gjatë përfundimit të këtij projekti në Njësinë e Patentë Shoferit në Prishtinë, ministri Lekaj ka thënë se me

këtë projekt po vendoset një standard evropian në një testim të rëndësishëm, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

"e-Testimi" nga sot do të jetë funksional në Njësinë e Patentë Shoferëve në Prishtinë, kurse brenda vitit do të implemento-

het në tërë territorin e Kosovës. Ky projekt ka kushtuar afër 240 mijë euro, ku 200 mijë kanë kushtuar serverët shumëdimensional që janë vendosur në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), ku edhe do të ruhen të gjitha të dhënat e kandidatëve që testohen.



BERZh-i dhe Oda Amerikane diskutojnë mundësitë e mbështetjes së sektorit privat

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se BERZh-i ofron mundësi të mira të financimit për sektorin privat, duke shtuar se portofoli i investimeve në vend është rritur përgjatë viteve. Zeka ka theksuar se Oda Amerikane do të donte të shihte rritje të pjesëmarrjes së sektorit privat në portfolin e investimeve të BERZh-it që momentalisht nuk shkon mbi 30 për qind

oritetet kryesore të BERZh-it në misionin e saj në Kosovë, duke përmendur se deri tani janë investuar 322 milionë euro në vend gjatë viteve paraprake dhe kanë mbështetur mbi 800 ndërmarrje përmes kështillimit të biznesit.

Rreth zhvillimit dhe mbështetjes së sektorit privat, Taylor ka theksuar zhvillimin e programit të konkurrueshmërisë të lansuar më herët në partneritet me ProCredit dhe BpB rreth ofrimit të mbështetjes financiare ndaj mikrobizneseve dhe bizneseve të vogla ku, përveç kësaj, tha se zhvillimi i infrastrukturës si dhe rritja e numrit të projekteve në sektorin e energjisë së ripërtëritshme janë disa nga sektorët ku BERZh-i synon mbështetjen e

saj. Taylor ka shtuar se ndër shqetësimet kryesore të BERZh-it për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në vend mbesin sundimi i dobët i ligjit, duke përmendur edhe nivelin e korrupsionit, ekonominë jofor-male etj.

Mes të tjerash, ai përmendi disa prej investimeve të kësaj banke në Kosovë duke përfshirë një numër të sektorëve të ndryshëm si energjinë, fuqizimin e grave ndërmarrëse e të tjera.

Më tutje, bizneset e pranishme patën rastin të diskutojnë për fusha të ndryshme, ku investimet nga BERZh-i do të mund të ndihmonin në zhvillimin e tyre si në ekonominë digjitale, ndërtimtari etj.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 KORRIK - Mbështetja e sektorit privat përmes financimit të projekteve të ndryshme nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është më se i nevojshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në vend si dhe tërheqje të investimeve të huaja direkte. Kjo u tha gjatë

tryezës së organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me udhëheqësin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovë, Neil Taylor.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se BERZh-i ofron mundësi të mira të financimit për sektorin privat, duke shtuar se portofoli i investimeve në vend është rritur përgjatë

viteve. Zeka ka theksuar se Oda Amerikane do të donte të shihte rritje të pjesëmarrjes së sektorit privat në portfolin e investimeve të BERZh-it që momentalisht nuk shkon mbi 30 për qind.

Udhëheqësi i BERZh-it për Kosovë, Neil Taylor, ka thënë se mbështetja ndaj sektorit privat përmes financimit të projekteve të ndryshme nga BERZh-i dhe kështillimit mbetet një ndër pri-



Aeroporti në bashkëpunim me kompaninë "Kujtesa" ofron internet falas për udhëtarët

Prishtinë, 3 korrik (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" në bashkëpunim me kompaninë

"Kujtesa" nga e mërkura ka filluar të ofrojë internet falas për të gjithë udhëtarët që shfrytëzojnë aeroportin. "E tëra çfarë

duhet të bëjnë udhëtarët që të kenë qasje të pakufizuar në internet është të sigurohen se e kanë të aktivizuar opsionin

wifi në pajisjet e tyre", thuhet në njoftimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".



Klina nderon dëshmorin Muhamet Haxhaj

KLINË, 3 KORRIK (ER) - Në Kompleksin Memorial "Kodra e Kuqe", te varrezat e dëshmorëve në Grabanicë, janë bërë homazhe dhe janë vendosur kurora me lule në 21-vjetorin e

rënies heroike të dëshmorit të kombit Muhamet Haxhaj, i njohur si Naimi. Në homazhe kanë marrë pjesë drejtorë të drejtorive të Komunës së Klinës, asamblistë, miq dhe familjarë

të të ndjerit. Po ashtu, homazhe janë bërë edhe te lapidari "Kulla e Qëndresës" në Dollc. Muhamet Haxhaj kishte rënë në fushën e nderit më 3 korrik të vitit 1998.



Një shkollë e Danimarkës dhuron inventar për tri shkolla në Malishevë



MALISHEVË, 3 KORRIK (ER) - Shkolla "Allerslev Skole" në Komunën Lejre të Danimarkës ka dhuruar donacion për tri shkollat fillore të mesme të ulëta në Komunën e Malishevës, shkollën "Bajram Curri", "Xheve Krasniqi-Lladroci" dhe "Visar Krasniqi". Pjesë e donacionit janë 300 karrige dhe 200 banka. "Kontributdhënës janë edhe bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në Mbretërinë e Danimarkës, po ashtu edhe Komuna e Malishevës e cila ndihmoi në lehtësimin e transportit dhe

me dokumentacion përkatës doganor", është thënë në njoftimin e Komunës së Malishevës.

Sipas personit kontaktues Arton Krasniqit, edhe në të ardhmen do të vazhdohet bashkëpunimi me Komunën e Malishevës dhe komunat e tjera në Danimarkë për shkollat e Malishevës që kanë nevojë me inventar apo edhe mjete mësimore.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka falënderuar bashkatdhetarët të cilët po kontribuojnë edhe në liri për vendlindjen e vet.

Komuna e Drenasit bën thirrje për shfrytëzim racional të ujit të pijes


DRENAS, 3 KORRIK (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, ka njoftuar qytetarët e kësaj komune se në javët e fundit me ngritjen e temperaturave është shtuar konsumi, respektivisht shfrytëzimi joracional i ujit, e cila ka filluar të shkaktojë çrregullim në

furnizim me ujë për shumë konsumatorë. Sipas kësaj komune, ditë më parë Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina" u ka bërë thirrje të gjithë konsumatorëve në zonën e Drenasit, që ujin e pijshëm ta shfrytëzojnë sa më racionalisht në këtë periudhë, për pije dhe higjienë dhe assesi për destin-

ime të tjera që konsiderohen të paarsyeshme. "Uji i pijes nuk bën në asnjë mënyrë që të keqpërdoret për çështje të panevojshme si për ujitje dhe larje rrugësh etj. Keqpërdoruesit e ujit që zihen duke e keqpërdorur ujin do të gjobiten sipas legjislacionit në fuqi", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



Inspektorët e Gjakovës do t'i inspektojnë shoqëritë tregtare



GJAKOVË, 3 KORRIK (ER) - Me synim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, Drejtoria për Punë Inspektuese, respektivisht inspektorët e tregut në Gjakovë gjatë kësaj jave do të fillojnë inspektimet me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, me fokus të veçantë do të mbikëqyret nëse janë duke u shërbyer konsumatorët nën moshën 18-vjeçare me

pije alkoolike dhe duhan. Komuna e Gjakovës ka bërë me dije se inspektimet do të fokusohen në shoqëri tregtare me veprimtari: aktivitetet shërbyese lëvizëse të pijeve (bareve dhe diskotekave). "Në rast se inspektorët e tregut konstatojnë se personat juridikë apo fizikë kanë shitur, shërbyer ose ofruar pije alkoolike dhe duhan personave nën moshën 18-vjeçare do të ndër marrin masa ndëshkuese të përcaktuara me ligj", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.

Komuna e Vitisë vazhdon përkujdesjen shëndetësore për të moshuarit



VITI, 3 KORRIK (ER) - Një ekip shëndetësor ka qëndruar në fshatin Letnicë të Vitisë, saktësisht në ambulanten e fshatit, ku janë kontrolluar pacientët e rastit. Vjollca Kadolli-Halili, drejtore-

shë e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, ka bërë me dije se përpos vizitave mjekësore, pacientëve të këtij fshati, të cilët janë kryesisht të moshës së shtyrë dhe të komunitetit

kroat, do t'u jepet terapia e nevojshme. Komuna e Vitisë edhe në të kaluarën është interesuar për të moshuarit e këtij lokaliteti duke u ofruar ndihma dhe shërbime të nevojshme shën-

detësore. Drejtoresha Kadolli-Halili ka potencuar se vizitat e tilla shëndetësore do të vazhdojnë edhe në të ardhmen në këtë lokalitet duke ditur nevojën të cilën kanë banorët e saj për shërbime shëndetësore.

Pse është e pamundur të mposhtet nacionalizmi?



Stephen M. WALT

Ideja që njerëzit formojnë fise të veçanta bazuar në një gjuhë, kulturë, përkatësi etnike dhe vetëdije të përbashkët dhe që grupe të tilla duhet të jenë në gjendje ta qeverisin vetveten, ka diktuar historinë e 500 vjetëve të fundit, në mënyra që ende shumë njerëz nuk i kuptojnë plotësisht.

Ishte nacionalizmi, ai që nxiti vendimin e britanikëve për të dalë nga Bashkimi Evropian, edhe pse liderët e lëvizjes nuk po e kuptojnë, se dalja nga unioni ka të ngjarë të varfërojë shumicën e britanikëve, dhe kjo mund të çojë në shpërbërjen e mundshme të gjithë Mbretërisë së Bashkuar.

Presidenti amerikan, Donald Trump, e përdori nostalgjinë nacionaliste për një të kaluar të imagjinuar ("Ta bëjmë Amerikën sërish të madhe) për të hyrë në Shtëpinë e Bardhë në vitin 2016, dhe nacionalizmi përbën ende bazën e politikave të tij proteksioniste dhe anti-emigrante, të cilat garantojnë besnikërinë e mbështetësve të tij.

Nacionalizmi është thelbësor edhe për përpjekjet ambicioze të presidentit kinez Xi Jinping, për ta bërë Kinën një lidere botërore, dhe është termi i përbashkët që bashkon politikanët e krahut të djathtë evropian në Francë, Austri, Itali, Hungari dhe Poloni. Në fakt, kudo nacionalizmi shihet sot në veprim.

Por pse nacionalizmi është kaq i

fuqishëm, dhe pse ndikimi i tij është kaq shumë i rëndësishëm? Së pari, njerëzit janë qenie sociale. Nga momenti që lindim, ne i përkasim një lloj ta caktuar komuniteti - një familje, fisi, fshati, krahinë, dhe sot një vendi të caktuar.

Për shkak se ne varem që në fillim nga ata që na rrethojnë, njerëzit kanë evoluar për të qenë shumë të ndjeshëm ndaj dallimeve mes grupit dhe atyre jashtë grupit. Të ishe në gjendje të identifikojë dikur miqtë dhe armiqtë e tu, ishte jetike për mbijetesën, dhe është kognitivisht më e lehtë të mbështetesh mbi tregues të thjeshtë ("ai flet gjuhën time", "ai duket ndryshe nga grupi im"), sesa të bësh një vlerësimi të thellë të karakterit apo prirjeve të tjetrit.

Duke pasur parasysh këto imperativa evolucioniste, nuk është e habitshme pse ne njerëzit jemi më të ndjeshëm ndaj dallimeve të tilla, më shumë sesa duhet të ishim në fakt. Kjo s'do të thotë që nuk mund të shohim përtej fiseve tona, apo të krijojmë lidhje të fuqishme me të tjerët, apo se nuk mundemi të ripërcaktojmë me kalimin e kohës se kush është "brenda" apo "jashtë" grupit.

Thënë thjeshtë: kemi një prirje të fortë për t'u identifikuar më fuqishëm, me ata që i konsiderojmë se janë "si ne". Deri tani, "kombi" ka qenë grupimi më i madh kulturor me këtë lloj tërheqjeje të qëndrueshme për anëtarët e tij. Tiparet përcaktuese që përbëjnë një komb mund të ndryshojnë, por zakonisht përfshijnë një gjuhë dhe kulturë të përbashkët, një origjinë territoriale dhe një narrativë të përbashkët të së kaluarës kolektive.

Më e rëndësishmja, një komb është një grup njerëzish, të cilët

e konsiderojnë veten si një komunitet unik me një identitet të veçantë. Sikurse shprehej Benedikt Anderson, kombet janë "komunitete të imagjinuara", ku të panjohurit e njohin dhe pranojnë njëri-tjetrin si pjesë të të njëjtit grup.

Për më tepër, siç e thekson Xhon Mearshajmer në librin e tij të fundit "Zhgënjimi i madh", fuqia e nacionalizmit mbështetet pjesërisht në marrëdhënien e tij simbiotike me shtetin. Duke pasur parasysh presionet konkurruese të qenësishme në një botë pa një autoritet qendror, shtetet kanë nxitje të fuqishme për të inkurajuar unitetin kombëtar brenda kufijve të tyre, në mënyrë që qytetarët të jenë besnikë dhe më të gatshëm të sakrifikojnë për shtetin kur është e nevojshme.

Pra, në botën moderne kombet duan që shtetet e tyre të sigurojnë mbijetesën dhe autonominë e tyre, ndërsa shtetet nxisin nacionalizmin për të forcuar veten, dhe ruajtur pavarësinë e tyre. Lëvizjet nacionaliste shpresojnë të shtojnë radhët e shteteve anëtare të OKB-së, ndërsa shtetet bëjnë atë çka mundën për të shtypur lëvizjet e pavarësisë brenda kufijve të tyre, dhe për të krijuar një trupë homogjene të qytetarëve besnikë.

Në raste ekstreme, minoritetet dëbohen, masakrohen ose "ri-edukohen" (siç po përpiqet të bëjë Kina me popullsinë e ujqurëve në Xinjiang). Këto dy bërthama, kombi dhe shteti, ndihmojnë në shpjegimin se pse nacionalizmi mbetet një forcë aq e fuqishme dhe e vazhdueshme. Dhe mos u gënjeni: ndikimi i tij është shumë i thellë. Edhe individët tepër të arsimuar dhe në përgjithësi skeptikë (siç jam edhe vetë), nuk janë aspak të imunizuar ndaj efekteve të saj.

Por, përse duhet të shqetësohemi për këtë fenomen të fuqishëm dhe të qëndrueshëm? Së pari, për shkak se ndjenja kombëtare shfrytëzohet lehtësisht nga udhëheqësit politikë, përfshirë shumicën e demagogëve, aktivitetet e të cilëve aktualisht po diktojnë politikën në mbarë botën.

Autoritarë potenciale si kryeministri hungarez Viktor Orban, apo oportunistë cinikë si britaniku Boris Xhonsen, mund t'i bindin mbështetësit e tyre, se ata janë të vetmit mbrojtjes kundër rënies kombëtare, apo madje edhe shfarosjes.

Së dyti, narrativat nacionaliste inkurajojnë standardet e dyfishta. Amerikanët denocojnë Rusinë e presidentit Vladimir Putin për veprimet e tij në Ukrainë, por ne harrojmë se ne kemi bërë shumë gjëra të ngjashme në të kaluarën. Për shembull, të njëjtën njerëz që kërkuar me ngulm që ShBA-ja të pushtonte Irakun në vitin 2003 (mbi bazën e argumenteve të dyshimta, dhe "provave" të fabrikuara), ishin të parët që nxituan të sulmojnë Rusinë për ndërhyrjen e saj në Ukrainë.

Së treti, nacionalizmi mund të hyjë në rrugën e kompromisit potencial politik, sidomos kur përfshihet territori i supozuar i shenjtë kombëtar. Serbia, nuk kishte ndonjë arsye racionale që të përpiqej ta mbante Kosovën në vitin 1999 (popullsia lokale përbëhej më shumicën dërrmuese nga shqiptarët e Kosovës që janë armiqësorë ndaj Beogradit, dhe vetë rajoni nuk kishte ndonjë vlerë të madhe strategjike apo ekonomike), por Beogradi nuk mund të lejonte shpëputjen, pasi Kosova ishte djepi i identitetit kombëtar serb. Së katërti, nacionalizmi ka qenë prej kohësh një burim i mundshëm i besimit të tepruar, sepse

shumica (në mos të gjitha) mitet kombëtare, përfshijnë pretendime për superioritet ndaj të tjerëve. Pra, na thuhet shpesh që kombi ynë jo vetëm është i ndryshëm nga të gjithë të tjerët, por është edhe më i miri.

Nacionalizmi, është i vështirë të ndahet nga krenaria kombëtare, dhe krenaria e bën më të vështirë besimin se të huajt mund të na mundin ne në një garë të drejtë. Sigurisht, nacionalizmi nuk është pa virtyte. Bindja e individëve për të bërë sakrificë për të mirën e përbashkët, nuk është një gjë e keqe, dhe një shkallë e shëndetshme e unitetit politik dhe e krenarisë në arritjet e vërteta të një vendi, është sigurisht më e preferueshme ndaj luftërave të egra dhe të hapura që kanë përçarë sot shumë demokraci.

Sidoqoftë, nacionalizmi nuk do të zhduket ndonjëherë. Prandaj, sfida është të njohim vlerat e tij, dhe të kufizojmë anët e tij negative. Kjo, është sigurisht më e lehtë të thuhet se sa të bëhet. Më së paku, duhet të njihet dhe respektohet fuqia dhe këmbëngulja e tij.

Ndër të tjera, një respekt i shëndoshë ndaj fuqisë së nacionalizmit, do të dekurajonte shtetet e fuqishme nga mendimi se mund ta riformesojnë botën sipas dizenjave të tyre të veçanta, dhe të na ndihmojë të shmangim fantazitë hysterike që kanë shkaktuar aq shumë dëme vitet e fundit. Ne jetojmë në një botë me nacionalizëm të furishëm, që nuk do të ndryshojë së shpejti, dhe pranimi i këtij fakti përbën një bazë të mirë për të ndërtuar një politikë të jashtme më realiste.

(Autori është profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Harvardit, ShBA. Marrë nga "Foreign Policy" - Bota.al)

Gashi: Kosova meriton anëtarësimin në TRADUK

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin e Panairit të Librit në Leipzig, Oliver Zile.

Ministri Gashi e ka falënderuar Zile për mundësinë e dhënë që vendi ynë të marrë pjesë në Panairin e Librit në Leipzig me autorët dhe stendën e posaçme. Po ashtu, ministri Gashi gjatë këtij takimi me Zile kanë diskutuar edhe për hapat përfundimtarë drejt anëtarësimit zyrtar të Kosovës në TRADUK-i, duke kërkuar mbështetje nga zyrtarët e Panairit të Leipzigut të cilët kanë një peshë dhe rëndësi të

veçantë në këtë proces të rëndësishëm dhe tepër të nevojshëm për vendin tonë.

Drejtori Zile ka përgëzuar ministrin Gashi për punën dhe përkushtimin që ka pasur në krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës në Panairin e Leipzigut, duke potencuar rëndësinë e vazhdim-it të pranisë së Kosovës në këtë panair dhe duke theksuar që ai dhe ekipi i tij drejtues edhe në të ardhmen do të bëjnë çdo gjë për ta ndihmuar praninë e vlerave kulturore të Kosovës në këtë panair. "Pjesëmarrja e Kosovës sivjet në Panairin e Leipzigut nuk është e rastësishme, andaj vendi



ynë do ta shndërrojë në traditë pjesëmarrjen në këtë panair të rëndësishëm të librit, i cili është ndër panairët më të vjetër në botë, ku sidomos autorët luajnë një rol të rëndësishëm me

prezantimet e tyre", ka thënë Zile.

Republika e Kosovës për herë të parë sivjet është prezantuar me stendë në Panairin e Librit në Leipzig. Panairi në Leipzig njihet

edhe si Panairi i Autorëve dhe Evropës Lindore dhe Juglindore. Edhe pse me përmasa më i vogël sesa në Frankfurt, është në fokus të jetës kulturore gjermane dhe evropiane çdo pranverë.

Me rreth 200 000 vizitorë dhe 3 000 botues nga Gjermania dhe vende të ndryshme të botës, sivjet Kosova ka qenë risia e këtij panairi.

Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës sivjet e ka përkrahur Bibliotekën Kombëtare të Kosovës për pjesëmarrje në Panairin e Librit në Leipzig e cila në stendën e saj ka prezantuar botimet më të reja nga Republika e Kosovës.

Putini miraton daljen nga traktati bërthamor

MOSKË, 3 KORRIK - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ratifikoi të mërkurën pezullimin nga Rusia të pjesëmarrjes në Traktatin e çarmatosjes

bërthamore INF të nënshkruar gjatë Luftës së Ftohtë me ShBA-në. Sipas një dekreti të bërë publik nga Kremli dhe që hyn në fuqi menjëherë pas nën-

shkrimit, Rusia nuk do të qëndrojë më konform me këtë tekst të nënshkruar në vitin 1987 nga dy fuqitë dhe që pengon përdorimin, vetëm nga këto, të

raketave tokësore me një rreze nga 500 në 5500 kilometra. Ky vendim i njoftuar në shkurt ishte miratuar në qershor nga Parlamenti rus.



Irani thotë se do ta shtojë pasurimin e uraniumit

Presidenti iranian Hassan Rouhani tha se që nga e diela Irani është gati të fillojë të pasurojë çdo sasi që dëshiron dhe u zotua se do ta rifillojë ndërtimin e reaktorit me ujë të rëndë Arak, një projekt që Irani ra dakord të mbyllet kur nënshkroi Planin e Përbashkët të Veprimit në vitin 2015

TEHERAN, 3 KORRIK - Presidenti iranian Hassan Rouhani tha të mërkurën se Irani do të fillonte pasurimin e uraniumit në nivele më të larta brenda disa ditësh nëse nuk sheh më shumë ndihmë në lehtësimin e sanksioneve nga vendet që nënshkruan marrëveshjen e vitit 2015, e cila vendosi kufizime ndaj programit bërthamor të vendit. Kjo marrëveshje kishte për qëllim zbutjen e shqetësimeve se Irani po përpqej për ndërtimin e një arme bërthamore dhe, ndër të tjera, i ndalonte Iranit të pasuronte uranium mbi nivelin 3.67%. Po sipas marrëveshjes, Irani mund të mbante vetëm 300 kilogramë material bërthamor në rezervat e veta. Niveli prej 3.67% është i mjaftueshëm për synimin për të prodhuar energji bërthamore, por ky nivel është shumë më i ulët sesa niveli i pasurimit prej 90%, që nevojitet për prodhimin e armëve bërthamore.

Rouhani tha se që nga e diela Irani është gati të fillojë të pasurojë "çdo sasi që dëshiron" përtej nivelit prej 3.67%. Ai u zotua më tej se do ta rifillojë ndërtimin e reaktorit me ujë të rëndë Arak, një projekt që Irani ra dakord të mbyllet kur nënshkroi Planin e Përbashkët të Veprimit në vitin 2015. Irani ka kërkuar mbështetjen evropiane pasi Shtetet e Bashkuara u tërhoqën nga marrëveshja vitin e kaluar dhe vendosën disa raunde sanksionesh të reja, duke përfshirë masat që syno-

jnë sektorin e naftës, me shumë rëndësi për ekonominë e Iranit. Teherani njoftoi këtë javë se kishte tejkaluar tashmë limitin prej 300 kilogramësh të uraniumit të pasuruar, por zyrtarët, përfshirë edhe ministrin e Jashtëm Mohammad Javad Zarif, kanë thënë se Irani është gati të kthehet te respektimi i kufizimeve në kuadër të Marrëveshjes së vitit 2015, nëse merr ndihmën ekonomike nga vendet e tjera të përfshira në marrëveshje. Të gjithë nënshkruesit e tjerë të martën shprehën shqetësim rreth shkeljes së kufirit të vendosur për rezervat e Iranit.

Britania, Franca, Gjermania dhe Bashkimi Evropian thanë, në një deklaratë të përbashkët, se ishin "të vendosur dhe të qartë se angazhimi ynë ndaj marrëveshjes bërthamore varet nga bashkëpunimi i plotë i Iranit" dhe i kërkoi Republikës Islamike të përmbahet nga veprimet e mëtejshme që minojnë marrëveshjen. Të tri këto vende dhe Bashkimi Evropian thanë se janë duke shqyrtuar urgjentisht hapat e ardhshëm.

Rusia dhe Kina, dy fuqi të tjera botërore që i kanë qëndruar marrëveshjes së vitit 2015, gjithashtu kundërshtuan shkeljen nga Irani të klauzolës për sasinë e rezervave të uraniumit. Ministri i Jashtëm rus Sergej Lavrov i bëri thirrje Iranit që "të tregojë përmbajtje dhe të mos udhëhiqet nga emocionet", si dhe t'i zbatojë dispozitat e mar-



rëveshjes. Gjithashtu, ai fajësoi sanksionet ekonomike të ShBA-së kundër Iranit, duke thënë se ato e penguan Teheranin ta shesë uraniumin e tepërt që po prodhon, një kërkesë e marrëveshjes.

Kina shprehu një pikëpamje të ngjashme, duke shprehur keqardhjen se Irani e tejkaloi limitin e rezervave, por duke shtuar se presioni ekonomik i Uashingtonit kundër Teheranit ishte në thelbin e problemit. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze Geng Shuang

tha: "Siç kemi theksuar vazhdimisht, presioni maksimal i Shteteve të Bashkuara është shkaku kryesor i tensionit aktual në çështjen bërthamore të Iranit".

Dakota Wood, ish-ushtarak i lartë dhe studiues i fushës së mbrojtjes në Fondacionin e Trashëgimisë Konservatore në Uashington, fajësoi fuqitë evropiane, Rusinë dhe Kinën, për reagimet e tyre ndaj veprimeve të Iranit. "Nënshkruesit e tjerë të marrëveshjes e kanë aftësinë për të

marrë veprime për këtë, për të sfiduar atë që po bën Irani, por po dëgjojmë se këto vende po refuzojnë ta bëjnë këtë", tha koloneli në pension i Korpusit të Marinës amerikane Wood në një intervistë për "Zërin e Amerikës". "Kjo me të vërtetë tregon se sa pak presion është ushtruar ndaj Teheranit nga këto vende për zbatimin e marrëveshjes dhe kjo ishte arsyeja përse presidenti Trump u tërhoq prej saj. Marrëveshja kishte shumë të meta", shtoi ish-koloneli amerikan.

OKB: Sulmi në Libi arrin nivelin e krimit të luftës

NJU JORK, 3 KORRIK - Një sulm ajror, i cili la të vrarë mbi 44 migrantë në një qendër ndalimi jashtë kryeqytetit të Libisë, Tripoli, "arrin nivelin e krimit të luftës", thanë Kombet e Bashkuara. Mbi 130 njerëz të tjerë u plagosën në sulmin, për të cilin u fajësuan forcat e generalit Khalifa Haftar. Trupat e tij e akuzojnë qeverinë në Tripoli për sulmin.

Shumica e viktimave besohet se janë afrikanë sub-saharianë, që kanë bërë përpjekje të arrijnë në Evropë nga Libia, përmes detit.

Mijëra migrantë mbahen në qendrat e paraburgimit në Libi.

Kreu i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Libi, Ghassan Salama, shprehu tronditjen e tij nga sulmi teksa vizitoi qen-

drën e paraburgimit në Tajoura, ku strehohen rreth 600 migrantë.

Në vitet e fundit Libia ka qenë një rrugë kryesore për migrantët që përpqejnë të arrijnë në Evropë. Ky vend është shkatërruar nga dhuna dhe ndarja qëkur udhëheqësi i tij veteran, Muammar Gaddafi, është rrëzuar nga pushteti dhe është vrarë në vitin 2011.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Keni parë ndonjëherë një luan duke fjetur gjumë mbi pemë?

Një luan në një park kafshësh të egra është fotografuar ngjitur në pemë duke marrë reze dielli dhe duke u relaksuar. 'Mbreti i xhunglës' u fotografua në degët e pemës. Fotografitë u realizuan nga Vince Burton në Elizabeth National Park në Uganda. 46-vjeçari ka theksuar se luanët



nuk janë kafshë që njihen se ngjiten në pemë ndryshe nga macet e tjera, si leopardët.

FOTO E DITES



Rojet e nderit shihen përpara ceremonisë mikpritëse të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan në Pekin. /AP/

E rrallë

Ishulli i Madagaskarit, i vetmi prodhues afrikan i havjarit

I famshëm për jetën e tij të egër, unik në prodhimin e vaniljes, ishulli i Madagaskarit ka edhe një tjetër kartë drejt famës: është burimi i havjarit të parë dhe të vetëm afrikan. Pronarët e biznesit janë të vendosur se ushqimet luksoze mund të luajnë një rol të rëndësishëm për



përmirësimin dhe rritjen e ekonomisë lokale. "Shumë njerëz qeshnin me ne. Por, na u desh pak kohë që të provonim se e gjithë kjo ishte serioze. Havjari i Madagaskarit është tani i vetmi havjar i prodhuar në Afrikë dhe oqeanin indian", ka pohuar një banor.

BARSOLETA E DITËS



Njëri që deshi të bëhej polic ndoqi një kurs të cilin e drejtonin të huajt. Kur kishin testin përfundimtar atij i shtrohet pyetja: Nëse e sheh një hajdut duke e vjedhur një dyqan, çfarë do të bëni? Kandidati: Do ta thërras policinë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)

"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00

"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg




Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray




Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Një ditë e mbushur me kënaqësi të vogla që do t'ju bëjnë më tolerant dhe më të dashur me familjen tuaj. Kishit kohë pa u ndier kështu.</p>	 <p>DEMI Keni lejuar që problemet e punës të bëhen pjesë e jetës suaj personale dhe kjo do t'ju krijojë mjaft ngërç në komunikimin me partnerin.</p>	 <p>BINJAKËT Dikush ju ka përfshirë pa dëshirën tuaj në një marrëdhënie mjaft të komplikuar. Të pamundur për të dalë, do të bëheni pjesë e rrjedhës.</p>	 <p>GAFORRJA Sot ndiheni shumë mirë me veten sepse keni zbuluar çelësin se si të jeni të lumtur edhe nga gjërat e vogla që mbushin ditën tuaj.</p>	 <p>LUANI Situatat që po ju ndodhin kohët e fundit janë shumë të ndikueshme nga gjendja juaj emocionale. Mundohuni ta ndani arsyen nga ndjenja.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Përvoja juaj ju ka mësuar të mos flisni para kohe për çështje që nuk i njihni mirë. Heshtja tregon më shumë se fjalët.</p>
 <p>PESHORJA Në sipërfaqe duket sikur jeni shumë në rregull, por në brendësi ka një çështje që po ju shqetëson dhe një person që tërheq gjithë vëmendjen tuaj.</p>	 <p>AKREPI Ju mungon përqendrimi, por duhet patjetër të sforcoheni sepse një projekt i caktuar që keni marrë përsipër kërkon gjithë vëmendjen tuaj.</p>	 <p>SHIGJETARI Megjithëse e keni të qartë se kush do të jetë e ardhmja juaj, përsëri doni të jeni të sigurt nga ana financiare për ta përballuar.</p>	 <p>BRICJAPI Gjithçka që mund të bëni sot është ta kënaqni veten duke i bërë sa më të këndshme çastet e ndryshme që do t'ju ofrojë dita.</p>	 <p>UJORI Respektin që kanë të tjerët karshi jush e keni vendosur me shumë mund. Një keqkuptim i vogël mund të prishë të gjithë imazhin e krijuar.</p>	 <p>PESHQIT Mos u trembni nëse duhet t'i ndryshoni në çastin e fundit projektet tuaja. Ndonjëherë ndryshimet janë shumë për mirë.</p>

Angelina Jolie tregon arsyet pse nuk ka nisur një tjetër romancë që nga ndarja me Brad Pittin



Angelina Jolie që nga ndarja me Brad Pittin në vitin 2016 nuk ka pasur ndonjë burrë tjetër në jetën e saj. Përderisa Bradi ka pasur një numër takimesh me shumë yje që nga ndarja, Angelina ka ruajtur romancën në minimum dhe kjo ka një arsye. Ajo nuk ka

pasur asnjë takim dhe burimet e afërta me të thonë se aktorja që ajo nuk ka asnjë plan për të filluar një të tillë apo të shikojë për ndonjë partner tjetër. Sipas një raporti në "Hollywood Life", Angelina është fokusuar në profesionin e saj dhe në çështjet familjare.

Priyanka Chopra tregon detaje të reja rreth dasmës



Aktorja e njohur indiane, Priyanka Chopra, ka thënë se ajo është duke u njohur çdo ditë e më shumë me bashkëshortin e saj Nick Jonas. Ajo në një intervistë për "Elle UK" ka treguar edhe për disa detaje të tjera rreth dasmës dhe martesë së

saj. "Ne e gjetëm vendin e dasmës në tetor, ndërsa u martuam më 1 dhjetor. Ne kishim një muaj e gjysmë për ta planifikuar dasmën, kështu ne vendosëm të martohemi dhe thamë me njëri-tjetrin le të martohemi", ka thënë Chopra në këtë intervistë.



Kylie pozon në plazh

Bilionerja Kylie Jenner pozon për ta promovuar linjën e saj më të re të bikinive, pjesë e koleksionit

veror për vitin 2019. Ylli televiziv shfaqet në fotot e saj me një kapele të madhe dhe bikini ngjyrë argjendi.

Nën shkëlqimin e shtatzënisë, Rose ecën rrugëve të Hollywoodit



Amber Rose është duke shijuar muajt e shtatzënisë. Ajo është parë duke ecur rrugëve të

Hollywoodit teksa ka bërë pazar me një mik. Rose me krenari ka shfaqur barkun e saj duke ecur me veshje sportive.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Sahiti: Eliminimi i Prishtinës, humbje për Kosovën

Muharrem Sahiti për "Epokën e re" ka thënë se eliminimi i Prishtinës nga Liga e Evropës është humbje për futbollin e Kosovës. "Eliminimi nuk është aspak i mirë jo vetëm për Prishtinën, por edhe për futbollin e Kosovës. Këtë eliminim duhet ta marrim si mësim se në këto nivele nuk ka lojë apo kundërshtar të lehtë. Duhet të jemi më të organizuar, sidomos klubet që shpallen kampionë dhe fitojnë kupën", ka thënë Sahiti



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 KORRIK - FC Prishtina të martën pësoi humbje në ndeshjen kthyesë të paraeliminatorëve në Ligën e Evropës nga Joseph's (2-0) dhe në këtë mënyrë është eliminuar edhe nga Evropa. Trajneri i njohur në Kosovë, Muharrem Sahiti, që është edhe ndihmestrajner në Përfaqësuesen e Kosovës, ka thënë se eliminimi i kryeqytetasve është humbje jo vetëm për Prishtinën, por edhe për futbollin e Kosovës në përgjithësi. Sahiti për "Epokën e re" e ka pranuar se ka pritur që skuadra më e madhe e Kosovës të kualifikohet më tutje në këtë garë. "Humbjen dhe eliminimin e Prishtinës i ka pritur shumë rënd pas i pritur se skuadra jonë do të kualifikohet tutje. Mund të them se kundërshtari nuk ishte klub amator, sepse e dëshmon fakti se e ka eliminuar Prishtinën. Kam qenë shumë i interesuar ta shikoj lojën, por e kisha të pamundur dhe dëshira ime ishte ta shoh punën e kartonëve. Eliminimi nuk është aspak i mirë jo vetëm për Prishtinën, por edhe për futbollin e

Kosovës. Këtë eliminim duhet ta marrim si mësim se në këto nivele nuk ka lojë apo kundërshtar të lehtë. Duhet të jemi më të organizuar, sidomos klubet që shpallen kampionë dhe fitojnë kupën", ka thënë Sahiti.

Ndryshe nga Prishtina, Feronikeli që është kampion dhe fitues i Kupës në Kosovë, arriti të kualifikohet në rrethin e parë të Ligës së Kampionëve. Sahiti vlerësoi se "Nikli" e ka përmbushur objektivin dhe se në këtë sukses i ka ndihmuar fakti se ndeshjet i ka zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". "Mund të them se Feronikeli e ka përmbushur një objektiv të mirë në parakualifikimet e Ligës së Kampionëve ku arriti kualifikimin. Mund të them se ka fituar më meritë të plotë, por nuk duhet harruar se i ka ndihmuar shumë fakti se ka qenë vendës", ka deklaruar ai.

Kundërshtarë e radhës e skuadrës nga Drenasi është TNS-ja.

Lidhur me shanset e Feronikelit ndaj këtij kundërshtari, Sahiti ka vlerësuar se janë të barabarta. "Tash Feronikeli do të ballafaqohet me një kundërshtar të nivelit më të lartë dhe

me përvojë më të madhe, por kam besim se skuadra jonë do të jetë më e përqendruar dhe më e motivuar. Sa i përket kualifikimit, nuk mund të jap prognozë sepse do të jetë shumë vështirë. Do të isha shumë i kënaqur nëse 'Nikli' tregon paraqitje të mirë për faktin se do të ishte një reklamë e mirë për futbollin e Kosovës. Gjasat për kualifikim janë 50 me 50", ka shtuar Sahiti.

Ditët e fundit është zhvilluar një debat që sulmuesi më i mirë në Kosovë, Kastriot Rexha, të ftohet në Përfaqësuesen e Kosovës. Ndihmestrajneri i "Dardanëve" ka thënë se aktualisht në përfaqësues janë lojtarë të nivelit të lartë si Rashica, Zeneli dhe Muriqi, por dyert e përfaqësues janë të hapura për çdo futbollist. "Ashtu siç ka deklaruar selektori po deklaroi edhe unë, se dyert e përfaqësues janë të hapura për çdo futbollist. Ne secilin futbollist e analizojmë në detaje. Dhe, pavarësisht se ku luan, mundësitë janë të barabarta. Në momentin kur kemi lojtarë edhe në ligën e Kosovës të nivelit të Rashicës, Zenelit apo Muriqit, normalisht se do t'i ftojme", ka përfunduar Sahiti.

SHKURT

Arifaj vazhdon të luajë me Dukagjinin

Skuadra e Dukagjinit nga Klina po vazhdon përgatitjet për edicionin e ri në IPKO Superligë. Kjo skuadër ka arritur të zgjasë bashkëpunimin edhe për një vit me sulmuesin Granit Arifaj. "Zyrtarisht lojtar i KF Dukagjinit edhe këtë sezon", ka thënë sulmuesi shtatlartë i cili ka luajtur edhe për Istogun, Drenicën, Hajvalinë dhe Feronikelin.

Ndarja e keqe nuk e pengon Tahirin të rikthehet sërish te Vushtrria

Portieri Petrit Tahiri ishte ndarë në mënyrë jo të mirë me skuadrën e Vushtrrisë, por kjo nuk i ka penguar të rikthehet vetëm pas gjashtë muajsh. Portieri me përvojë të madhe e ka konfirmuar, nëpërmjet një postimi, se në edicionin e ri futbollistik do të jetë pjesë e skuadrës që tash garon në Superligë. "Rikthehem aty ku e nisa me shkëmbimin e parë të topit dhe me kupa. Ndjenja për ta dërsitur fanellën e klubit të zemrës, 'ferri' i nxehtë vushtrrias që bëhet nga tifozët e flaktë 'Forca', projekti serioz i klubit për të ardhmen si dhe trajneri shumë i suksesshëm në vitet e fundit në Kosovë, Bekim Shotani, ishin arsye e rikthimit te Vushtrria", ka shkruar Tahiri.

Kosova mposhti Moldavinë, por përfundon e pesta

Përfaqësuesja e Kosovës në volejball në konkurrencën e femrave U19 ka arritur të fitojë në ndeshjen e fundit të Kampionatit Ballkanik kundër Kombëtares së Moldavisë. Me këtë fitore Kosova ka arritur ta fitojë vendin e pestë në këtë garë. Kosova fitoi me rezultat 3 me 1 në sete me rezultatet: 27:25, 19:25, 25:15, 27:2. Në fakt Kosova zhvilloi ndeshje mjaft të mirë edhe kundër Rumanisë, mirëpo nuk arriti të shënojë fitore me çka do ta siguronte pjesëmarrjen në fazën finale të garës.

Operohet Callandesi, Ademi i uron shërim të shpejtë

Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, është operuar të martën dhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i ka uruar shërim të shpejtë. "Pas operimit që pati dje përzgjedhësi Bernard Challandes, në gju, shfrytëzoj rastin që në emrin tim dhe në emër të Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës t'i uroj atij shërim sa më të shpejtë. Roli i tij në ecurinë e ekipit tonë përfaqësues është shumë i rëndësishëm, prandaj ne e presim përzgjedhësin Challandes që të kthehet sa më i fortë në shtator kur na presin dy sfidat e radhës. Zotit Challandes i urojmë shërim të shpejtë, shëndet të plotë e po ashtu vazhdimësi të rezultateve të mira me përfaqësuesen", ka thënë Ademi.

Mazrekaj: Do ta mposhti djalin e Arkanit

PRISHTINË, 3 KORRIK - Boksieri me prejardhje nga Kosova, Petrit Mazrekaj, ka bërë me dije se synon fitoren në meçin ndaj Veljko Raznatović, i cili është djali i kriminelit serb Arkan. Mazrekaj ka folur të martën në "Imazh" të RTK-së për meçin e planifikuar për 31 gusht. Ai ka thënë se

ftesa djalit të Arkanit ka ardhur pasi që i kishte rrahur keq në Serbi tre boksierë serbë dhe, sipas Mazrekajt, ai po pretendon të marrë hak. "Unë e fitoj meçin. Nuk kam qejf të flasë shumë, por me punë të kallëzoj atë që duhet. Ky është pak më i gjatë sesa unë, por unë e di që

goditjen e kam shumë të rëndë. Janë shumë komponentë që duhet të jenë dhe unë mendoj që i kam të gjitha nga pak", ka thënë ai. Boksieri Mazrekaj konfirmoi se meçi nuk do të zhvillohet në Beograd, por në një vend neutral në Gjermani ose Zvicër.



Zyrtarizohet sporti i Ragbit në Kosovë

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim, në kabinetin e vet, ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell. Qëllimi i këtij takimi ishte zyrtarizimi i Federatës së Ragbit në Kosovë, si dhe konkretizimi, konsolidimi dhe promovimi i mëtejme i këtij sporti në vendin tonë. Me këtë rast, ministri Gashi falënderoi ambasadorin britanik për bashkëpunimin e deritashëm dhe kontributin e tij për sportin e Ragbit dhe shprehi gatishmërinë për të vazhduar edhe më tutje këtë bashkëpunim, duke synuar të realizojnë bashkërisht projekte në fusha të ndryshme. Po ashtu, ministri Gashi e uroi ambasadorin për hapjen e Federatës së Ragbit në Kosovë dhe u dëshiroi mbarëvajtje në garat që do të organizohen në këtë sport. "Sot është një ditë e veçantë për sportin në Kosovë pasi që sot po e zyrtarizojmë Federatën e Ragbit. Ne si MKRS do të angazhohemi maksimal-



isht që ta japim kontributin tonë për zhvillimin e këtij sporti me pak traditë në vendin tonë", ka thënë ministri Gashi. Ndërkaq ambasadori O'Connell falënderoi ministrin Gashi për

pritjen dhe gatishmërinë e tij për krijimin e Federatës së Ragbit në Kosovë dhe u shpreh i kënaqur që MKRS-ja po u krijon mundësi të reja sportistëve në Kosovë.

Hatton: Fury, boksieri më i mirë në botë



MANCHESTER, 3 KORRIK - Legjenda e boksit britanik Ricky Hatton pretendon se Tyson Fury i meriton të gjitha lëvdatat dhe e meriton të vlerësohet si boksieri më i mirë në kategorinë e peshave të rënda në planet. Ish-kampioni i dyfishtë botëror, Ricky Hatton, beson se Tyson Fury është boksieri më i mirë sesa bashkëkombësi tjetër i tij, Anthony Joshua, i cili së fundi i humbi titujt botërorë. "Nuk mund të kishte qenë më i mirë,

po tregohem i sinqertë. Ai nuk e mposhti një kampion bote, nuk e zgjodhi boksierin më të fortë në divizion, por ai e mposhti një boksier të klasës botërore, të pamposhtur më parë, në kategorinë e peshave të rënda, brenda dy rundeve", ka thënë Hatton për "talkSport.com". "Schwarz nuk arriti ta godasë as edhe një herë të vetme. Ai e ngriti nga toka dhe filloi ta rrahë sërish. Tysoni është i njohur për aftësinë e tij për të

boksuar, për mbrojtjen dhe lëvizjet e tij, por ju e patë edhe anën e keqe të cilin ai e ka brenda vetes, gjithashtu. Ai është përmirësuar që nga meçi kundër Wilderit, po bëhet më i mirë e më i mirë. Mendoj se ai e meriton të njihet si më i miri në kategorinë e peshave të rënda. Ai mund të mos i ketë titujt, por mendoj se kushdo që e ka parë do të thoshte se ai është më i miri tash për tash", ka deklaruar ai.

SHKURT

Gashi nuk rikthehet në Zvicër

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Shkëlzen Gashi, do ta respektojë kontratën me Colorado Rapidsin deri në fund, ani pse klubi nga liga MLS më nuk llogaritet në shërbimet e tij. "Blick" ka njoftuar të martën se Gashi ka refuzuar ofertën e ekipit nga Zvicra, Grasshopper, që të kthehet për të luajtur në Evropë. 30-vjeçari ka qenë pjesë e Grasshopperit për dy vjet (2012-2014), kurse karrierë në Zvicër ka bërë edhe tek Aarau, Xamaxi, Zuerichu, Bellinzona dhe Schaffhausen.

Buffoni sot kalon testet mjekësore te Juventusit

Çdo gjë është e kryer, Gianluigi Buffon do të rikthehet te Juventusit. Portieri italian do të kalojë sot (e enjte) vizitat mjekësore në "J Medical" dhe do të jetë afrimi i katërt këtë merkato. Lajmin e konfirmon "Sky Sport", që bën me dije se Buffoni do të nënshkruajë kontratë njëvjeçare, pastaj do të bëhet pjesë e stafit drejtues të "Zonja". Kështu, 41-vjeçari do ta veshë sërish fanellën e Joves pas një sezoni te PSG-ja dhe është gati ta thyjë rekordin e Maldinint për sa iu përket pranisë më të shumta në Serinë A.

Toure prezantohet në Kinë

Yaya Toure u rikthye verën e kaluar tek Olimpiacos, por aventura e dytë me ekipin nga Pireu nuk shkoi mbarë dhe mesfushori nga Bregu i Fildishtë ndërpreu bashkëpunimin me klubin grek në muajin dhjetor. Më 10 maj Toure bëri publik largimin e tij nga futbolli i luajtur, por oferta e fundit ia ka ndryshuar mendjen dhe ka vendosur të rikthehet. 36-vjeçari ka gjetur marrëveshjen me klubin e ri dhe do të transferohet në Kinë. Toure është prezantuar si përforcimi më i ri i Qingdao Huanghai, klub që garon në divizionin e dytë të futbollit kinez dhe renditet në vendin e parë.

Atletico zyrtarizon transferimin e Felipes

Mbrojtësi Felipe është zyrtarizuar si lojtar i ri i Atletico Madridit, kurse ka nënshkruar kontratë trevjeçare. "Felipe Augusto de Almeida Monteiro mbërrin në aeroportin e Madridit të mërkurën. Brazili, i cili do të firmosë një kontratë trevjeçare me klubin më 4 korrik, do ta nisë menjëherë fazën përgatitore me ekipin", shkruan Atletico në faqen e vet zyrtare. Felipe luajti 142 ndeshje në 3 sezone, me 11 gola të shënuar, ndërsa ka luajtur 27 ndeshje në Ligën e Kampionëve.

Messi kritikon gjyqtarët dhe Brazilin

Argjentina nuk mundi të kualifikohet në finalen e Kupës së Amerikës, pasi humbi nga Brazili me rezultatin 2-0. Ishte një tjetër shans i hedhur poshtë për Leo Messin që të fitonte një trofë me kombëtaren. Pas ndeshjes ai shfaqti shumë pakënaqësi ndaj gjyqtarëve dhe nuk ngurroi ta sulmojë Brazilin. "Gjyqtarët nxorën shumë kartonë pa fund për budallaqe dhe VAR-in as që e kontrolluan. Kjo ishte e pabesueshme. Prisa që CONMEBOL të bënte diçka për arbitrimin, por nuk besoj se ka për të ndodhur më, sepse Brazili kishte çdo gjë nën kontroll, manipulon gjithçka. Është çështje e koklavitur", ka thënë Messi. "Përtej rezultatit bëme një paraqitje shumë të mirë. Luajtëm shumë mirë dhe kundërshtarët nuk ishin më të mirë se ne. Besoj se skuadra ka një bazë, djemtë bënë një sakrificë të madhe dhe meritojnë respekt. Argjentina ka lojtarët që të bëhet më e mirë", ka deklaruar Messi.



Republika e Kosovës Komuna e Prizrenit
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti Opština Prizren – Prizren Beledijesi

DATE/A:	03.07.2019
REFERENC-Ë	2003/2019
NGA/OD/FROM:	Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren,
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për përmirësimin e konkursit Nr. 1998/19 të datës 02.07.2019

